

Prof. dr. Naser FERRI

MITHRAIZMI-RIVAL I KRISHTËRIMIT NË GARË PËR RELIGJION ZYRTAR TË PERANDORISË ROMAKE

Gjatë shekujve të parë të erës sonë në Dardaninë e pushtuar nga romakët kishin filluar të depërtojnë kultet e panteonit shtetëror romak por edhe kultet joromake (kryesisht me origjinë greko-orientale) që i sollën me vete ushtarakët, zyrtarët e administratës romake dhe familjarët e tyre si dhe përcjellësit e romakëve (tregtarët, zejtarët e artistët, skllëvërit, të liruarit e të tjerë).¹

Romakët në trojet e pushtuara dardane sollën format e reja ekonomike-sociale, ato të rregullimit të ri politik si dhe rrymat e reja kulturore. Ndikimi romak solli si pasojë bashkimin e kulturës romake me traditat autoktone lokale, kurse në fushën e besimeve dhe kulteve, pos dëshmime mbi ekzistimin e kulteve të hyjnive epikoike vendëse janë zbuluar edhe mjaft gjurmë të kulteve të hyjnive të huaja që i sollën romakët në këto vise e në mesin e tyre kishte edhe mjaft hyjni me origjinë orientale të cilat arritën këtu së bashku me turmat heterogjene që i përcillnin pushtuesit romakë. Në viset e pushtuara depërtonin së pari kultet oficiale romake dhe kultet e hyjnive orientale të cilët më herët kishin arritur në Romë², por më vonë këto kulte depërtonin jo vetëm përmes Romës por edhe përmes rrugëve të tjera.

Në pjesën qendrore të Dardanisë romake, respektivisht në territorin e Kosovës së sotme janë gjetur relikte të disa nga kultet e hyjnive me prejardhje nga Lindja (Dolichenus, Nemesis, Isis, Osiris,

1 N. Ferri, *Monumentet ushtarake të periudhës romake në Mezi të Epërme*, Dukagjini Pejë 2001, f. 105-116.

2 E. Čerškovič, *Rimljani na Kosovu i Metohiji*, Beograd 1969, f. 64.

Dea Syria e të ngjashme), ndërsa nga të gjitha këto kulte, për nga rëndësia, dallohet ai i hyjit Mithra përkundër fakti se ky kishte lënë më pak gjurmë së kultet e ngjashme orientale. Ç'është e vërteta deri më tash janë gjetur vetëm dy monumente që kanë të bëjnë me kultin e hyjit Mithra në Kosovë, ndërsa vetëm në njërin nga ato është paraqitja figurale e cila është tejet karakteristike për ritin e kultit mithraik.³

Kulti i hyjit indo-persian Mithra u krijua në Indi dhe bazohej mbi parimin e luftës së vazhdueshme mes së mirës dhe së keqës. Nga India kulti i Mithrës u transferua në Persi prej nga arriti në Romë, ndërsa nga Roma u përhap anembanë Perandorisë dhe u bë kulti më i ri pagan në Perandori. Kah mesi i shekullit III, respektivisht rreth vitit 250 të erës sonë ishte bërë rival serioz i krishterimit në garë për religjion zyrtar të shtetit romak⁴ dhe e kishte humbur këtë garë për pak, vetëm fal ndikimit tejet të madh të së ëmës së perandorit Konstandini i Madh në të birin e vet⁵. Po ta kishte fituar Mithra këtë garë, një pjesë e madhe e popullsisë së botës sot kishte qenë mithraiste.

Si dëshmi e ekzistimit të dikurshëm të këtij kulti janë ruajtur mjaft relikte të tempujve nëntokësore, pastaj një numër i konsiderueshëm i skulpturave dhe të ikonave prej guri si dhe disa dokumente të shkruara kundër paganizmit nga koha paleokrishtere⁶, ndërsa krishterimi, pasi që ishte bërë fe zyrtare e Perandorisë romake, i ka përvetësuar shumë elemente të doktrinës së mithraizmit.

Mithra, Mithras ose Mitra ishte hyj indo-persian i dritës dhe i diellit⁷, kulti i të cilit ishte tejet i përhapur në Azi, ndërsa gjatë periudhës së antikës edhe në Perëndim, posaçërisht në Perandori Romake. Pos mitologjisë induse dhe persiane Mithra përmendej edhe në mitologjinë armene, por këtu njëhej me emrin Mherr ose Mehrer dhe konsiderohej hyj kozmopolit.⁸ Kulti i tij bazohej mbi dualizmin mazdaist që kishte

3 E. Imamović, *Antički kultni i votivni spomenici na području BiH*, Biblioteka kulturno nasljeđe, Sarajevo 1977, f. 279.

4 M. Dixon-Kennedy, *Encyclopedia of Greco-Roman Mythology*, Santa Barbara-California, Denver-Colorado, Oxford-England 1998, f. 210.

5 M. Jović, *Rano hrišćanstvo na Balkanu*, Niš 1994, f. 20.

6 D. Srejšević, *Arheološki leksikon*, Beograd 1997, f. 671-672.

7 J. Forty, *Mythology, A Visual Encyclopedia*, Parkgate Books, London 1999, f. 156.

8 R. Cavendish & T. Ling, *Mitologija, Ilustrirana enciklopedija*, Mladost Zagreb 1982, f. 201.

të bëjë me luftën e vazhdueshme ndërmjet të së mirës, që e përfaqëson Ahura Mazda(hyj krijues dhe simbol i metamorfozës nga besimet pagane në ato monoteiste)⁹ dhe së keqes, e cila ishte e mishëruar në qenien negative dhe shkatërruese të Ahrimanit.¹⁰



Koka prej bronzi e gjetur në Erzinzhan(Armeni) e hyjneshës së virgjër Anahite, e cila sipas mitologjisë, ishte e ëma e Mithrës

Në mitet më të lashta persiane thuhet se Mithra ishte një nga 7 hyjnitë apo ahurat të lindur nga vetë Ahura Mazda si kundërpeshë kundër demonëve negativ të krijuar nga Ahrimani¹¹, por nga ana tjetër në mite përmendët si “petrogenes”, pra i lindur nga shkëmbi ashtu siç edhe drita qiellore lind nga kupa gjigante qiellore.¹² Sipas miteve armene lidhur me lindjen e Mithrës, ai paraqitet edhe si “parthenogenes”, meqë sipas kësaj mitologjie, atë e kishte lindur virgjëresha Anahite (në mitologjinë

9 J. Forty, vep. cit..., 64; D.Srejović & A. Cermanović-Kuzmanović, *Rečnik grčke i rimske mitologije, Srpska književna zadruga*, Beograd 1996, f. 363.

10 N. Philip, *Annotated Myths&Legends*, Dorling Kindersley, London 2001, f. 21; L. Melgar-Valero, *Enciclopedia de la Mitologia*, Libsa 2008, f. 33.

11 B. Colonna, *Dizionario mitologico, divinita,eroine ed eroi, re e regine, satiri e nimfe, muse, giganti, mostri, oracoli e sibille*, Rusconi libri, Roma 2003, f. 32.

12 Srejović & Cermanović-Kuzmanović, *Rečnik grčke i rimske mitologije...*, f. 363-365.

persiane hyjnesha Anahita-hyjneshtë e ujërave)¹³ në një shpellë afër një përroi, ku barinjët kishin filluar ta adhurojnë duke i sjellë dhurata hyjit të posalindur. Fill pas lindjes ishte konfrontuar me Solin (Diellin), të cilin e kishte mposhtur dhe pastaj ishin bërë miq, kështu që Mithra ishte bërë edhe “forcë e dritës”. Pas kësaj e Mithra e kishte flijuar demin e egër të shenjtë. Derisa Mithra kishte qenë duke e flijuar demin, Ahrimani i kishte dërguar gjarprin (i cili duhej ta helmonte gjakun e demit) dhe akrepin (i cili duhej ta helmonte spermën e demit) që ta pengonin krijimin e gjallesave, të bimëve dhe të njeriut, por ky tentim i tij kishte përfunduar pa sukses dhe nga pjesët e demit ishin krijuar gjallesat e ndryshme: nga trupi ishin krijuar bimët, nga kockat dhe bishti-drithi, nga gjaku-hardhia e rrushit, ndërsa nga sperma e demit ishin krijuar kafshët e ndryshme si dhe njerëzit.¹⁴ Ahrimani ndërkaq nuk ishte pajtuar me disfatën dhe kishte dërguar më së pari thatësinë e pastaj, pasi nuk kishte arritur që me thatësi t’i shkatërrojë ato që i kishte krijuar Ahura Mazda kishte dërguar edhe përmytjen dhe zjarrin e madh,¹⁵ por përkundër këtyre tentimeve të Ahrimanit Mithra kishte arritur ta shpëtojë njerëzimin. Pas këtyre të bëmave, sipas mitit, Mithra e kishte përfunduar jetën e tij tokësore dhe me karrocën diellore ishte ngritur në Qiell në mesin e hyjnive. Meqë sipas mitologjisë mithraiste pritej që ai të rikthehet si shpëtimtar ky kult faktikisht kishte futur në doktrinën religjioze nocionin e ringjalljes shumë para krishterimit.¹⁶

Karakteri i kultit

Mithra ishte hy i rendit, i cili në përpjekje për ta vendosur rendin ishte bërë edhe perëndi i luftës dhe i luftëtarëve. Mendohet të ketë qenë hy ndërmjetësues mes Ahura Mazdës hyjnor dhe të njerëzve të vdekshëm, respektivisht ndërmjet të Qiellit dhe Tokës.

Kulti i këtij hyji nderohej nëpër vende të posaçme të quajtura mitrejtë dhe spelejtë që ishin shpellat natyrore ose artificiale (zakonisht

13 H. S. Robinson & K. Wilson, *Mitovi i legende starih naroda, Izdavačko preduzeće*, „Rad“ Beograd 1976, f. 43.

14 R. Cavendish & T. Ling, *Mitologija*, f. 154.

15 D. Srejšević & A. Cermanović-Kuzmanović, *Leksikon religija i mitova drevne Evrope, drugo dopunjeno izdanje, Savremena administracija*, Beograd 1979, f. 271.

16 *Le Livre des Religions*, Gallimard Paris 2004, f. 107.

nëntokësore ku kishte ujë të rrjedhshëm), në të cilët kryheshin ritet. Mithrejët kryesisht kishin dimensione të vogla, zakonisht rreth 25 X 10 m., për çka edhe numri i besimtarëve që mund të merrnin pjesë në rite fetare ishte tejet i kufizuar dhe sillej deri në 30 persona. Ritet mithraike kishin karakter të mistereve sipas modeleve orientale, ndërsa një ndër veçoritë kryesore të këtij kulti ishte fakti se gjatë kryerjes së ceremonive fetare ishte rreptësisht e ndaluar pjesëmarrja e femrave.¹⁷

Ceremonitë e nderimit të kultit të Mithrës i udhëhiqte kleriku apo prifti i quajtur Pater, i cili paraqitej me ikonografi të caktuar: me shkop në dorë, pastaj kishte shpatën e kthyer, kapelën dhe unazën e posaçme karakteristike.

Baza religjioze e kultit të Mithrës ishte lufta e vazhdueshme mes së mirës (Ahura Mazda) dhe së keqes (Ahriman), ndërsa doktrina kryesore bazohej mbi rrugëtimin e shpirtit i cili, sipas besimeve mithraiste, është i pavdekshëm. Sipas doktrinës mithraike, besohej se shpirti gjatë lindjes i kalonte sferat e ndryshme planetare, kurse jeta konsiderohej si periudhë e sprovave. Pas vdekjes së njeriut demonët e dritës dhe të errësirës luftonin për shpirtin, ndërsa ata të “drejtët” (besimtarët) vetë Mithra personalisht i dërgonte në “mbretërinë e dritës” ku i merrte në pyetje, i gjykonte, e vlerësonte se a kanë bërë mëkate apo jo, dhe atyre që ishin të pastër nga mëkatet ua epte eliksirin e pavdekshmërisë të përbërë nga vera dhe gjaku i demit të flijuar.¹⁸

Pos të tjerash mitologjia mithraike ishte edhe përplot me simbolikë astrale. Sipas doktrinës mithraike ashtu siç duhej t’i kalonte 7 sfera me rastin e lindjes, shpirti i njeriut në të njëjtën mënyrë kthehej nga e njëjta rrugë pas vdekjes. Në kultin e Mithrës ishin prezentë edhe 4 elementet bazë të botës: uji, zjarri, toka dhe ajri, e po ashtu edhe 12 shenjat e Zodiakut, 7 planetët si dhe hyjnitë Soli (Dielli) dhe Luna (Hëna).¹⁹

17 N. Philip, *Annotated Myths&Legends...*, f. 21.

18 E. Curotto, *Dizionario della mitologia universale*, Torino 1958, 313-314; D. Srejšović & A. Cermanović-Kuzmanović, *Leksikon religjia i mitova*, f. 365.

19 R. Beck, *Planetary Gods and planetary orders in the mysteries of Mithras*, E. J. Brill, Leiden 1988, f. 2-4.

Pagëzimi-akti i inicimit mithraik

Akti i hyrjes së besimtarit në bashkësinë mithraike ose riti i inicimit i ngjante pagëzimit krishterë dhe kishte 7 nivele të cilët njiheshin me emra: korbi, dhëndëri, ushtari, luani, persiani, lajmëtari i Diellit dhe babai²⁰, kurse arritja e secilit nga këto nivele kërkonte prova teorike dhe praktike të qëndrueshmërisë fizike si dhe të asaj psikike, pas të cilave



Foto 1 - Paraqitja e skenës së tauroktonisë nëpër monumente të kultit mithraik

pasonte shugurimi dhe vetëm atëherë të shuguruarit konsideronin që janë të gatshëm të ballafaqohen me simbolin e së keqes - Ahrimanin, të luftojnë kundër tij, ta mposhtin atë dhe ta fitojnë jetën e amshueshme.

Në aspektin kronologjik mithaizmi ishte kulti më i ri (i fundit) pagan i cili kishte depërtuar në Evropë por përkundër kësaj kishte arritur që të bëhet kulti i nivelit shtetëror. Gjatë shekullit I të erës sonë, respektivisht në kohën e sundimit të perandorit Neron (54-68 të erës sonë) këtë kult e kishin sjellë në Romë ushtarët romakë të cilët shërbenin në legjione të stacionuara në Lindje, e pastaj përmes Romës në kohën e perandorit Vespasian (69-79 të erës sonë) ky kult ishte përhapur nëpër tërë Perandorinë Romake²¹ e në këtë mënyrë, gjatë shekullit II dhe III-të të erës sonë, edhe në viset tona.

20 R. Cavendish & T. Ling, *Mitologjia*, Zagreb 1982, f. 154.

21 Po aty, f. 153.

Në aspektin figurativ-ikonografik Mithra prezantohej në formë të paraqitjeve figurale në relieve, apo më radhë në trajtë të skulpturave të ngjyrosura. Në të dyja variantet zakonisht paraqitej në pozitë të flijimit të demit me kapele të tipit frigjias në kokë, i veshur me hiton (lloj këmishe) të shkurtër dhe me thikë, me hark dhe me shigjeta në duar. Pranë tij gjendeshin dy pishtar mbajtës: Kautesi, me pishtar të ngritur dhe Kautopatesi, me pishtar të ulur.²² Skenat e luftës kundër Solit, flijimi i demit, darka e fundit dhe ngritja e tij mbi Oqean në Qiell me karrocë të Diellit, ishin pjesë të paraqitjeve të tija të zakonshme figurale. Po ashtu, paraqiteshin edhe elementet negative që tentonin ta pengonin procesin e krijimit: gjarpri i cili tentonte ta pinte gjakun e demit dhe akrepi i cili tentonte ta helmonte farën e demit, ndërsa Mithrën e përcjellnin edhe hyjnitë: në anën e djathtë Soli kurse në të majtën Luna, të cilët i shoqërojnë korbi dhe qeni.²³

Arritja e mithraizmit në Romë dhe përhapja nëpër provinca

Në bazë të zbulimeve arkeologjike mendohet se fillimi i nderimit dhe krijimi i kultit të hyjit Mithra, hyj ky i Diellit dhe i dritës diellore kishte ndodhur në Indi në shekullin XV p.e.s. prej nga ishte përhapur në Persi gjatë shekullit VI para erës sonë, e më vonë edhe në Romë, e prej aty ishte përhapur anembanë botës së njohur në atë kohë. Mithra përmendet në librat e shenjta hinduiste-Vedat, por edhe në librin e shenjtë zaratustrian Avesti. Në Romë kishte arritur në shekullin I të erës sonë, së bashku me kultin e perëndisë Dolichenus, me origjinë nga Azia e Vogël²⁴, dhe aty e kishin sjellë ushtarët e perandorit Neron që kishin qenë në shërbim në Lindje²⁵, ndërsa nga Roma në kohën e perandorit Vespasian kishte filluar të përhapet anembanë Perandorisë romake²⁶ dhe bartësit dhe përhapësit e tij kishin qenë ushtarët romak, skllëvërit dhe të liruarit e më vonë ky kult u përfaqua edhe nga aristokracia e Romës

22 Lj. Zotović, *Nov spomenik Mitrina kulta, Starinar, nova serija IX-X*, Beograd 1958-1959, f. 207.

23 Lj. Zotović, *Mitraizam na tlu Jugoslavije*, Beograd 1973, f. 89.

24 F. Cumont, *Les Mysteres de Mithra*, Bruxelles 1913, f. 36.

25 Po aty.

26 V. Girardi-Jurkić, *Duhovna kultura antičke Istre*, Školska Knjiga Zagreb 2005, f. 211-212.

si dhe nga aristokracia provinciale. Kulti i Mithrës kishte arritur që të përhapet deri në ishullin e Britanisë, ndërsa gjatë shekullit II të erës sonë kishte depërtuar në provincat danubiane, që do të thotë se ishte përhapur në pjesën më të madhe të Perandorisë romake²⁷ respektivisht të botës së njohur në atë kohë.

Rivaliteti i mithraizmit me krishterimin

Përafërsisht nga v. 250 e.s. Mithraizmi u bë rivali më i madh i krishterimit në luftë për religjion zyrtar për shkak se nderohej në mënyrë të organizuar dhe kishte doktrinën dhe rregullat e qarta dhe të kapshme për të gjitha shtresat popullore. Mithra sipas mitit kishte lindur në stallë në formë shpelle, dhe atë pas lindjes e kishin vizituar të urtit dhe i kishin sjellë dhurata, po ashtu ishte partenogenes- i lindur nga virgjëresha e papërlyer (Anahite), pastaj Mithrën e quanin mësues, dhe i kishte pas 12 nxënës, ndërsa kulti i Mithres përmbante pagëzimin, një lloj kungimi, celibatin, ujin e bekuar që përdorej për purifikim (Mithra u lind në shpellë afër përroit), në ritin e tij përdorej buka e shënuar me kryq dhe vera që simbolizonte gjakun, dita e diele ishte ditë e shenjtë, kurse vetë Mithra, sipas mitit, ishte i lindur më 25 dhjetor, jetën e kishte kaluar në celibat, kishte bërë mrekulli dhe kishte shtruar darkën e fundit para ngritjes në qiell.²⁸ Adhuruesit e kultit të Mithrës vetën e quanin fratres (lat.-vëllezër), ndërsa priftin Pater (At).

Mithra po ashtu kishte qenë edhe model për krijimin e “Bariut të mirë” të krishter, pastaj ai shpeshherë identifikohet me luanin (figura e të cilit paraqitej në skenat e tauroktonisë) ose qengjin dhe konsiderohej shpëtimtar. Kur përfundoi lufta për religjion zyrtar të shtetit romak dhe kur krishterimi definitivisht e fitoi këtë luftë, kulti i Mithrës kishte qenë ndër kultet e para pagane që të krishterët filluan t’i persekutojnë pa mëshirë. Tempujt e Mithrës ishin shkatërruar, ndërsa mbi themele të tyre u ndërtuan kishat.

Meqë data 25 dhjetor konsiderohej ditëlindje e Diellit të Pamposhtshëm, mu për këtë arsye pikërisht më 25 dhjetor të vitit 274 të e.s., perandori romak Aurelian e kishte shpallë Mithrën patron kryesor

27 N. Philip, *Annotated Myths&Legends...*, f. 21.

28 T. Dhama, *Fjalor i mitologjisë*, Tiranë 1987, f. 168-169.

të Perandorisë Romake. duke ia dedikuar atij tempullin në Fushën e Marsit (Campus Martius). Ka gjasa që për shkak të adhurimit të Mithrës perandori-filozof Mark Aureli kishte qenë persekutues i madh i krishterimit dhe i ithtarëve të tij,²⁹ ndërsa ekzistojnë faktet epigrafike që perandorët romak Diokleciani, Galeri dhe Licini kishin qenë ithtarë të flaktë të Mithrës³⁰ dhe. përkundër faktit që anëtarët e familjeve të tyre e kishin përqaftuar krishterimin, ata kishin ndërtuar dhe rindërtuar tempuj për nder të Mithrës.³¹

Perandori Konstantini i Madh (me origjinë dardane nga Naissusi, sundoi prej v. 306 deri në v. 337), nëna e të cilit Helena, ishte ithtare e flaktë e krishterimit, në vitin 311 me bashkësundimtarin e tij Galerin, kishte lejuar predikimin e lirë e besimeve të ndryshme, ndërsa përmes të ashtuquajturit Edikt i Milanos të vitit 313 së bashku me perandorin Licinin kishte shpallur një lloj amnistie për të gjitha besimet, e në këtë kontekst në njëfarë mënyre edhe e kishte legalizuar krishterimin dhe i kishte ndaluar persekutimet e të krishterëve, por përkundër faktit që konsiderohej “perandori i parë i krishterë dhe mbrojtës i Kishës”³² ai deri në momentin e vdekjes në vitin 337 kishte mbetur ithtar i kultit të hyjit Mithra, ndërsa monedhat e prera në kohën e sundimit të tij në revers (shpinë) bartnin legjendën “Claritas et Invicto Soli”(Diellit=Mithrës së Ndrishëm dhe të Pamposhtur).³³ Për hir të Mithrës perandori Konstantini i Madh në vitin 321 e kishte shpallë ditën e diel (lat.Soli dies- dita e Diellit) ditë pushimi, por kjo ditë më vonë u riemërua nga krishterët në domenica (dita e Zotit) duke u bazuar në mitin biblik të krijimit sipas të cilit Zoti e kishte krijuar botën për 6 ditë ndërsa ditën e shtatë kishte pushuar.³⁴

Besimi që spelejtë (faloret mithraike nëpër shpella) e kohës romake ishin tempuj të cilët më shumë i përgjigjen karakterit të kultit të perëndisë persiane sesa tempujt e murosur, pa dyshim ka pasur parasysh bazën ekonomike, sepse besimtarët e Mithrës me mundësi të

29 M. Collins & M. A. Price, *Kršćanstvo, 2000 godina vjere*, Zagreb 2000, f. 47.

30 B. Cunliff, *Rome and her Empire*, McGraw-Hill Books Company Limited, Maidenhead (UK) 1978, f. 278-281.

31 M. Collins & M. A. Price, *Kršćanstvo...*, f. 54.

32 B. Cunliff, vep. cit..., f. 57.

33 Po aty, f. 285.

34 R. Cavendish & T. Ling, *Mitologija...*, f. 159.

veta modeste materiale nuk kishin mundësi që të ngritin tempuj, dhe për këtë arsye për kryerjen e riteve mithraike i kishin shfrytëzuar hapësirat e mbuluara në mënyrë natyrore.³⁵



Foto 2- Kisha San Clemente(Shën Klementi) në Romë

Njëri nga pasardhësit e Konstantinit, perandori Theodosi I (379-395) në koncilin e Nikesë të vitit 325 të erës sonë e kishte futur kryqin si simbol të besimit të krishterë³⁶, ndërsa me ediktin e 28 shkurtit të vitit 380 ai kishte tentuar që krishterimin të bënte fe të obligueshme për të gjithë banorët e Perandorisë Romake, e në të njëjtën kohë të krishterët kishin filluar t'i persekutonin ithtarët e Mithrës, kurse prej vitit 391 dhe gjatë shekullit V të erës sonë kishin filluar edhe t'i rrënojnë tempujt paganë, e në këtë kuadër edhe tempujt e Mithrës dhe të ndërtojnë kisha në vend të tyre.³⁷

Një nga shembujt më të njohur të këtillë është kisha San Clemente (foto 2) në Romë nga viti 1123, nën themelet e së cilës gjenden reliket e një bazilike paleokrishtere nga shekulli IV të e.s., ndërsa nën këtë bazilikë (në nivelin e tretë nëntokësor) edhe sot e kësaj dite gjendet një speleum nga shekulli III, mjaft mirë i ruajtur, më përre

35 Lj. Zotović, *Putevi širenja mitraizma na tlu jugoistočne Evrope*, Balcanica vol. II, Beograd 1971, f. 120.

36 *Opšta enciklopedija Larousse*, tom I, Beograd 1967, f. 518.

37 M. Collins & M. A. Price, *Kršćanstvo...*, f.59.

dhe relikte të afreskave, në të cilin është gjetur një shtatore e bukur e Mithrës (foto 3). Qysh me herët fillon, e në këtë kohë posaçërisht arrin kulmin shkatërrimi i librave të shenjta religjioze të mithraizmit. Përkundër të gjitha pengesave dhe ndalesave, në jetë të përditshme nderimi i kultit të Mithrës ishte ruajtur deri në shekullin V të erës sonë anembanë Perandorisë romake.³⁸

Mithraizmi në Dardani

Gjykuar në bazë të zbulimeve arkeologjike si dhe në bazë të dhënave relevante mund të supozohet se kulti i Mithrës kishte arritur në Mezi të Epërme (pjesën qendrore të territorit të te cilës e bënte ish Mbretëria Dardane) nga lindja, përmes Mezisë së Poshtme dhe përmes Dakisë³⁹ ku e kishin sjellë ushtarët romak dhe përcjellësit e tyre⁴⁰, ndërsa monumenti më i hershëm i kushtuar Mithrës në Dardani, i cili datohet në periudhën mes viteve 161 dhe 169 të erës sonë, është zbuluar në Naissus.⁴¹



Foto 3-Skulptura e Mithres nga mithreu nën kishën San Clemente në Romë

38 Po aty.

39 Lj. Zotović, *Putevi širenja mitraizma na tlu jugoistočne Evrope...*, f. 111.

40 E. Imamović, *Antički kultni i votivni spomenici na području Bosne i Hercegovine*, Sarajevo 1977, f. 281.

41 S. Dušani & P. Petrović, *Epigraphic contributions from the National Museum of Niš*, *Živa Antika* vol. 12/1, Skopje 1962 nr. 2, f. 371.

Nga faltoret e kultit të Mithrës të cilat zakonisht ishin të vendosura buzë, ose afër arterieve kryesore komunikuese provinciale (reliktet e tyre janë gjetur afër pikave doganore, kampeve ushtarake, vendbanimeve të romanizuara civile si dhe në afërsi të qendrave xehetare) në pjesën jugore të territorit dardan dihet për disa sosh, madje shumica gjendshin në rrethinë të Kumanovës së sotme (në fshatrat Bilanovc, Kleçovc dhe Llopatë) ndoshta edhe për shkak të faktit se në Mezi të Epërme, e cila përfshinte territorin e ish-Mbretërisë Dardane kulti i Mithrës nderohej vetëm nëpër tempuj të vegjël dhe të përkohshëm. Monumentet epigrafike që i kushtoheshin Mithrës bartnin formulat përkushtimore epigrafike siç janë: DSIM (Deo Soli Invicto Mithrae) dhe SIM Soli Invicto Mithrae), ndërsa Mithra në tekste përkushtimore pos epitetit Sol Invictus, bart edhe epitetet Augustus, Deus, Omnipotens si dhe shtesën Sacrum, dhe epitetet e shtesa të ngjashme.⁴²

Në fakt, në territorin e ish Dardanisë janë zbuluar disa tempuj si dhe gjurmë epigrafike në pjesën veriore të saj, ndërsa në pjesën jugore pos dy faltoreve dhe të monumenteve epigrafike në rrethinë të Kumanovës (Bilanovc, Kleçovc dhe në fshatin Llopatë), është zbuluar edhe një monument epigrafik në Shkup ndoshta i bartur nga rrethi i Kumanovës?) si dhe një ikonë prej guri (të cilës i mungon mbishkrimi) e zbuluar në Janjevë të sotme. Gjurmët arkitektonike e epigrafike të këtij kulti të zbuluara në rrethinë të Kumanovës i përkasin periudhës së shekullit III të e.s. meqë datohen në mënyrë precize sipas çiftit konsullor Gentiano et Basso (viti 211), ndërsa altari i zbuluar në Shkup datohet në vitin 216 sipas konsujve P.Catius Sabinus II dhe P.Cornelius Anullinus.⁴³ Kësaj kohe, pra fillimit të shekullit III, fal veçorive të saj, duhet t'i përket edhe ikona nga Janjeva.

Monumenti në fjalë (foto 4)⁴⁴ u zbulua në Janjevë në vitet e tridhjeta të shekullit XX, dhe për herë të parë u botua në vitin 1937. por

42 R. Marić, Antički kultovi u našoj zemlji, Beograd 1933, f. 82.

E. Imamović, Antički kulturni i votivni spomenici..., f. 277.

43 B. Dragojević-Josifovska, *Inscriptions de la Mesie Superieure, Scupi et la region du Kumanovo*, vol. VI, Centar za Epigrafiku i Numizmatiku, Beograd 1982, nr. 210, f. 165-166.

44 N. Vulić, *Antički spomenici naše zemlje*, Spomenik Srpske Akademije Nauka i Umetnosti, Beograd 1941-48, f. 106. E. Čerškov, Rimljani na Kosovu i Metohiji..., f. 67.

tash sa kohë gjendet në Muzeun Popullor në Beograd. Fjala është për një pllakë katërkëndëshe me mbarim harkor, me dimensione : 34 X 28 X 25 cm., e cila është punuar prej mermeri të bardh dhe ka paraqitjen figurale vetëm në avers ose në anën e përparme. Pllaka është e mbuluar me hark dhe është e ndarë në tri fusha, në qendrore prej të cilave është paraqitur skena e tauroktonisë (fljimi i demit) ku Mithra therë demin, të cilin e sulmojnë qeni dhe gjarpri. Mithra në momentin e therjes së demit e ka kokën e kthyer anash, ndoshta duke pritur shenjën nga Soli për ta therur demin,⁴⁵ apo sipas një mendimi tjetër e ka kthyer kokën nga dhembja sepse është duke e vrarë vëllanë e Krijuesit të Mirë.⁴⁶ Në këndin e lartë nga ana e majtë është paraqitur korbi, kurse në të djathtin paraqitet skena e njërit nga versionet e lindjes së Mithrës (lindja nga shkëmbi).

Në skenën e tauroktonisë janë prezent dadoforët, në pozitë statike duke qëndruar anash me këmbë të kryqëzuara.⁴⁷ Dadoforët si edhe vetë Mithra janë të veshur me rroba karakteristike: janë të mbështjellur me hlamida (një lloj pelerine), dhe në koka kanë kapelat frigjiase. Mes pishtarmbajtësit (dadoforit) të majtë dhe këmbës së Mithrës duket koka e luanit. Pishtarmbajtësi i majtë në dorën e djathtë mban bishtin e demit, ndërsa të majtën e ka të ngritur në drejtim të hlamidës së valëvitur të Mithrës. Pishtarmbajtësi i djathtë me njëren dorë mban pedumin e mbështetur në sup, ndërsa dorën tjetër si duket e ka të mbështetur mbi qafë të demit.

Në skenën kryesore të ikonës në fjalë paraqitet po ashtu edhe koka e luanit. Mënyra e paraqitjes së luanit në këtë rast del nga mënyrat e shabllonizuara të paraqitjes së luanit në monumente të këtilla në Ballkanin Qendror meqë në rastin tone pjesa e përparme e trupit të luanit paraqitet brenda skenës kryesore, mes këmbëve të dadoforit të majtë dhe të demit. Lidhur me paraqitjen e luanit konsiderohet se kjo figurë si motiv rrjedh nga provinca e Dakisë dhe që simbolizonte forcën të cilën luani ia dhuronte Mithrës, por nuk është e qartë se cili ishte roli i luanit në vetë aktin e fljimit.⁴⁸

45 Lj. Zotović. Nov spomenik Mitrina kulta. Starinar, Nova Serija vol.IX-X, Beograd 1959, f. 205.

46 R. Cavendish & T. Ling, Mitologija..., f. 153.

47 J. Medini, Diadora, vol. VIII, Zadar 1975, f. 55.

48 Lj. Zotović, Putevi širenja mitraizma na tlu jugoistočne Evrope..., f. 75, f. 105.

Ikona e gjetur në Janjevë për nga trajta i përket tipit të pllakave kënddrejta, me mbarim harkor dhe të ndara në tri fusha në mënyrë horizontale në të cilat janë të paraqitura skenat nga lindja, jeta dhe të bëmat e Mithrës, në mënyrë narrative-sukcesive, respektivisht në formë strupi me paraqitje të epizodave të cilat krijojnë një tërësi.

Pos kësaj, e veçanta e kësaj ikone është se i takon kategorisë së tipave të ikonave të cilat, pos skenës kryesore të flijimit të demit, kanë edhe frizin e epërm dhe atë të poshtëm ku janë paraqitjet epizodike të rëndësishme nga jeta e Mithrës

Në pjesën e ruajtur të frizit të epërm janë paraqitjet figurale të skenës së lindjes së Mithrës nga guri, busti i Solit si dhe skena e krijimit të ujit, element ky i cili, sipas psikanalistëve gjithmonë ka njëfarë lidhje me lindjen.⁴⁹ Për fat të keq paraqitjet e tjera janë tejet të dëmtuara edhe pse ka gjurmë të sigurta që kanë ekzistuar.



Foto 4-Pllaka me paraqitje të Mithrës duke flijuar demin e gjetur në Janjevë

Fusha e poshtme është e ndarë në katër pjesë, nga të cilat tri të parat janë të mbuluara me kupën harkore. Në pjesën e parë nga ana e majtë është paraqitja e hyjit Mithra duke mbajtur demin (Mithra tauroforos), pastaj skena e duelit të Mithrës kundër Solit (ku Soli është paraqitur i mposhtur dhe i gjunjësuar), ndërsa nga pjesa e tretë janë ruajtur vetëm dy koka, sipas gjasave pjesë e paraqitjes së drekës rituale të paktimit të Mithrës me Solin.⁵⁰

49 S. Frojd, *Uvod u psihoanalizu*, Beograd 1969, f. 142.

50 Lj. Zotović, *Mitraizam na tlu Jugoslavije*, Beograd 1973, f. 27-28.

Në bazë të madhësisë së pjesës së katërtë si dhe në bazë të analogjive, supozohet që këtu ka qenë e paraqitur apoteoza apo ngritja e Mithrës mbi karrocën e Diellit lartë, në botën hyjnore. Në pjesën rrethuese duhet të ketë qenë i skalitur mbishkrimi i cili për fat të keq nuk është ruajtur.⁵¹

Skena kryesore e ikonës nga Janjeva paraqet Mithrën duke e therur demin mu në momentin kur ai ia kishte vu thikën në qafë. Mithra ia kishte futur gishtat e dorës së majtë demit në vrima të hundës, kurse me dorën e djathtë është duke e ther demin me një thikë të gjerë mu nën qafë (foto 4).

Si edhe në paraqitjet e tjera të këtij lloji, Mithra në kokë mban kapelën frigjiase dhe ka të veshur një hiton lloj këmishe) me rrudha të dukshme e cila i ka mëngët e gjata dhe pantallonat e ngushta e të gjata. Mbi supet e Mithrës është paraqitur pelerina-hlamida, e valëvitur, sipas gjasave me qëllime praktike-artistike: që ta plotësojë hapësirën në fushën qendrore prapa Mithrës dhe për t'ia dhënë një pamje plastike paraqitjes së tërë në fushën qendrore. Në ikonën nga Janjeva nuk vërehen këpucët e thella të cilat zakonisht i bartte Mithra në këso lloj paraqitjesh.

Në këtë monument, në kuadër të skenës qendrore të tauroktonisë janë paraqitur edhe qeni dhe gjarpri. Sipas mitit qeni ishte ndihmës i Mithrës i cili i ndihmonte gjatë ndjekjes së demit si dhe të therjes së tij. Gjarpri është po ashtu protagonist i zakonshëm i skenës së tauroktonisë. Ishte një nga përcjellësit e Mithrës dhe kishte rolin aktiv në skenën e flijimit të demit. Sipas mitit gjarpri paraqet të keqën, dhe edhe në monumentin e Janjevës si edhe në shumicën e rasteve të tjera paraqitet me kokë të ngritur dhe me gojë të hapur, në drejtim të demit akoma të patherur, i gatshëm për ta pirë gjakun i cili simbolizon forcën jetike. Skenën e tauroktonisë zakonisht e përcjellë edhe akrepi i cili tenton t'ia sulmojë gjenitalet e demit, por jo në të gjitha paraqitjet e tauroktonisë, siç është rasti edhe në ikonën tone.

Sipas mitit, akti i flijimit të parë ishte zhvilluar në shpellë dhe mu për këtë arsye në paraqitjet mithraike theksohen elementët simbolike të shpellës në mënyra të ndryshme, ndërsa ka raste të paraqitjes së tërë pjesës hyrëse të shpellës.

51 Po aty, f. 87.

Anash skenës së tauroktonisë janë paraqitjet e pishtarmbajtësve apo dadoforëve Kautes dhe Kautopates. Këta janë paraqitur njëri me pishtar të ngritur lartë-Kautesi i cili simbolizon jetën, dritën, pranverën dhe lindjen dhe çdo gjë pozitive, ndërsa tjetri me pishtar të drejtuar poshtë-Kautopatesi, duke e simbolizuar kështu vdekjen, errësirën, vjeshtën dhe çdo gjë negative.⁵²

Si edhe në paraqitje të tjera figurale mithraike, Mithra e ka kokën e kthyer lartë në anën e djathtë ndërsa pishtarmbajtësit që zakonisht paraqitën pasivë, në gjendje statike, në rastin tonë janë të paraqitur aktivë: dadofori i djathtë në dorën e majtë mban pedumin të mbështetur në sup, ndërsa dorën e djathtë e ka të zgjatur në drejtim të demit. Dadofori i majtë në dorën e djathtë mban bishtin e demit, kurse të majtën e ka të ngritur në drejtim të hlamidës së valëvitur të Mithres. Është e dukshme mungesa e pishtarëve në paraqitjen figurale të këtij monumenti, të cilët i zëvendësojnë pedumet nga të cilët njëri kishte trajtën e shkopit dhe tjetri atë të harkut që i përngjajnë atyre nga provincat lindore të Perandorisë romake. Lëvizjet e duarve të lira të dadoforëve ndërkaq theksojnë angazhimin e tyre aktiv në aktin e flijimit.

Pos pjesëve të cekura ikona nga Janjeva ka edhe fushën e poshtme (frizin) që është një nga karakteristikat e paraqitjeve figurale mithraike në Mezi të Epërme e në këtë kontekst edhe në trojet dardane.

Frizi i poshtëm i ikonës së gjetur në Janjevë është i ndarë në katër pjesë ku në pjesën e parë është paraqitur Mithra taurofori (bartës i demit) që është njëra nga epizodat e veprave të Mithrës, respektivisht bartja e demit në shpellë ku duhej realizuar akti i flijimit të demit. Pjesën e dytë e përbën skena e duelit mes Mithrës dhe Solit, skenë kjo e pashmangshme në të gjitha paraqitjet figurale të këtij lloji. Nga pjesa e tretë e cila është tejet e dëmtuar, janë ruajtur vetëm dy koka, të cilat ndoshta janë pjesë e skenës së drekës rituale të pajtimit të Mithrës dhe Solit pas duelit nga i cili asnjëri nga këta nuk doli fitues dhe i cili përfundoi me darkë dhe me krijim të një miqësie të fortë.

Në fund të ikonës është një dëmtim për shkak të cilit mungon një pjesë në të cilën, sipas analogjive, duhej të ishte paraqitur skena e

52 Lj. Zotović, *Nov spomenik Mitrina kulta*, 207, Lj. Zotović, *Mitraizam na tlu Jugoslavije...*, f. 88.

apoteozës, respektivisht e ngritjës së Mithrës dhe të Solit me karrocë të Diellit në qiell, paraqitje kjo me të cilën përfundon cikli i paraqitjeve figurale të te bëmave të Mithrës dhe të jetës së tij në këtë botë. Ka mundësi që në skenën që mungon mund të ketë qenë paraqitja e Oqeanit, i cili në paraqitje të këtilla rregullisht e përcjellë ngritjen e Solit dhe të Mithrës në botën hyjnore.

Për shkak të dimensioneve të saj si dhe për shkak të faktit që ishte e dekoruar vetëm nga ana e përparme, është shfaqur mendimi se ikona mithraike e gjetur në Janjevë kishte qenë e murosur në murr të ndonjë godine, ndoshta një faltore(?)⁵³ e në të mirë të këtij supozimi flet edhe fakti që afër vendzbulimit të kësaj pllake rrjedhë një përrua.⁵⁴

Edhe pse modeli bazë i skenës ikonografike ishte i unifikuar në të gjitha provincat e Perandorisë romake dhe të gjitha monumentet me paraqitje figurale kushtuar Mithrës ishin të punuara sipas këtij modeli të standardizuar, megjithatë gjatë kohës dhe nëpër rajone të ndryshme ishin krijuar dallime të natyrës teknike apo ikonografike⁵⁵

Në bazë të te dhënave relevante mund të supozohet se kulti i Mithrës ka arritur në trojet dardane (që asokohe ishin në përbërje të provincës Mezia e Epërme) nga Lindja përmes Detit të Zi dhe provincës së Dakisë.

Zbulimet arkeologjike lejojnë mundësinë sipas të cilës në pjesën jugore të ish Dardanisë, rreth Scupit dhe Kumanovës kishte ekzistuar enklava e fundit mithraike në drejtim të jugut meqë në Maqedoni dhe Greqi Mithra nuk nderohej për shkak të averzionit e çdo gjëje që vinte nga Lindja, e pos kësaj dukët se as popullata vendëse ilire nuk e kishte pranuar këtë kult me vullnet.⁵⁶

Duke u bazuar mbi veçoritë ikonografike dhe mbi analogjitë dhe ngjashmëritë me monumente të këtilla të zbuluara në Scupi dhe në lokalitete të tjera të rajonit, mund të supozohet se ikona mithraike e Janjevës në aspektin kronologjik i përket shekullit III të e.s.

53 E. Čerškov, *Rimljani na Kosovu i Metohiji...*, f. 67.

54 B. Novobërdali, *Janjeva në mesjetë dhe sot*, Rilindja 1983, f. 15.

55 Lj. Zotović, *Putevi širenja mitraizma na tlu jugoistočne Evrope...*, f. 69.

56 V. Paškvalin, *Kultovi u antičko doba na području BiH, Glasnik Zemaljskog Muzeja*, vol. XVIII, Sarajevo 1963, f. 147.

Shkaqët e zhdukjes së kultit të Mithrës

Përkundër faktit se popullata ilire nuk e kishte pranuar kultin e Mithrës me dëshirë e ky kult ishte po ashtu jo i popullarizuar edhe në Greqi dhe në Maqedoninë fqinje megjithatë kishte raste të radha ku kulti i Mithrës nderohej së bashku me kultet e hyjnive epikorike, po në të njëjtin vend të kultit siç ishte rasti me sinkretizmin e këtij kulti me kultet e hyjnive ilire ose më konkretisht me hyjin Silvan në rajonet qendrore trojeve ilire, ku si duket Mithra kishte pas më shumë ithtarë.⁵⁷

Faktët dëshmojnë se dokrina e mithraizmit ishte shumë më e avancuar sesa ajo e krishtërit, por përkundër kësaj krishtërimi kishte ngadhnyer në garë për religjion zyrtar të Perandorisë. Pa dyshim këtu kishte ndikuar fakti se nëna e perandorit Konstantini i Madh, Helena e kishte përqaftuar këtë besim por edhe fakti se mithraizmi nuk e lejonte prezencën e femrave në tempuj gjatë ceremonive religjioze. Tregimi i peshkopit së Cezaresë Euzebit (ishte peshkop nga viti 315 deri më 340) mbi fitorën e Konstantinit tek Ura e Milviut në vitin 311 të erës sonë dhe shpjegimi mitologjik që pikërisht natën para betejës vendimtare atij iu kishte dëftuar në ëndërr simboli në formë kryqi dhe porosia “EN TOUTO NIKA” [greqisht: me këtë (simbol) fito],⁵⁸ që më vonë u latinizua në trajtën “Hoc signo vinces”, mund të jetë vetëm një arsytim subjektiv i faktit që Konstantini e liberalizoi politikën ndaj besimeve, kur e kemi parasysh faktin se ai nuk e kishte bërë këtë nga bindja personale e madje as vetë ai nuk e pranoi krishtërimin dhe kishte mbetur mithraist i bindur deri në vitin 337 të e.s., respektivisht deri në momentin kur ne shtratin e vdekjes më në fund ishte pagëzuar. Pas ngadhnjimit të besimit të tyre, të krishterët, përkundër persekutimit të egër që e ndërmorren kundër paganëve e posaçërisht kundër mithraistëve, i përvetësuan shumë elemente të besimit mithraik siç janë: lindja në shpellë, lindja nga virgjëresha, data e lindjes 25 dhjetori, uji i bekuar, pagëzimi, mrekullitë që i mvishën Krishtit, darka e fundit, ngritja në qiell e disa të tjerë,⁵⁹ të cilët edhe sot janë pjesë të doktrinës dhe ceremonive religjioze të krishtere.

57 E. Imamović, *Atički kultni i votivni spomenici na području Bosne i Hercegovine*, Sarajevo 1977, f. 280-281.

58 M. Collins & M. A. Price, *Kršćanstvo...*, f. 58.

59 T. Dhama, *Fjalori i mitologjisë...*, f. 169.

Roli i hyjit Mithra në mitologjitë e popujve të ndryshëm

Roli i Mithrës ishte i konsiderueshëm në mitologjitë e popujve të ndryshëm. Kështu bie fjala në mitologjinë hinduse ku edhe zuri fill nderimi i kultit të këtij hyji, Mithra kishte rolin e hyjit të dritës, ndërsa në mitologjinë persiane ishte mbrojtës i shoqërisë fisnore deri në kohën e Zarathustrës i cili e reformoi politeizmin persian mes viteve 628 dhe 558 p.e.s. Mitologjia armene gjatë shumë shekujve e përmend Mithrën si hyj kozmopolit i lindur ngja virgjëresha ndërsa epi popullor armen Sasunci David e zë ngojë si Mehrer i Madh dhe baba i Davidit, heroit legjendar të popullit armen. Në mitologjinë kineze Mithra konsiderohet mik dhe mbrojtës i njeriut në këtë botë dhe mbrojtës nga të këqijat në botën tjetër. Romakët e pranuan nga Persia si hyj të rendit e në këtë kontekst edhe si hyj të luftës, krishterët ndërkaq i konsideronin ritet mistike mithraike si rite satanike, kurse islami si edhe krishtërimi e luftonte nderimin e këtij kult.

Ky kult, i cili u paraqit në kohën e cila pak a shumë korrespondon me paraqitjen e judaizmit monoteist, dhe më përpyekjen e pasuksesshme të faraonit Amenofisi IV (1379-1362), i njohur si Eknaton⁶⁰, për futjen zyrtare të monoteizmit në Egjipt dhe shumë shekuj para krishtëritimit dhe islamit ka lënë gjurmë të pashlyeshme në besimet abrahamike, posaçërisht në krishtërimin i cili e luftoi në mënyrë aq të egër, por i cili megjithatë i përvetësoi shumë elemente nga ky kult paraardhës i monoteizmit, si dhe në sufizmin islam i cili, ndoshta për shkak të origjinës së vet nga Persia, përkundër distancës kohore, ka ruajtur shumë elemente të përbashkëta me mithraizmin, posaçërisht sa i përket simbolizmit, misticizmit dhe koncepteve poetike të literaturës sufiste që mund të kenë qenë inspiruar me elemente të filozofisë dhe doktrinës mithraike e para së gjithash lidhur me inicimin (shugurimin) e besimtarëve, i cili në mithraizëm e kishte numrin e caktuar të niveleve (korbi, dhëndri, ushtari, luani, persiani, lajmëtari i Diellit dhe Babai) ashtu si edhe në tarikatet sufiste (ashik, myhyb, dervish, shejh, baba dede) dhe në ritulin e zikrit, i cili ndoshta është inspiruar me ritet mistike mithraiste.⁶¹

60 R. Armour, *Zotat dhe mitet e Egjiptit të lashtë*, shtëpia Botuese Dudaj, Tiranë 2002, f. 166.

61 H. S. Robinson & K. Wilson, *Mitovi i legende svih naroda*, Beograd 1976, 46; J.

Nga ajo që u tha shihet se mithraizmi kishte lënë gjurmë në shumë besime, ndërsa e veçanta e tij është që ishte paraardhës i besimeve monoteiste dhe se shumë para këtyre besimeve në doktrinën e vet e kishte futur idenë e rigjalljes dhe të pritjes së Shpëtimtarit.

Prof. dr. Naser FERRI

SUMMARY

MITHRAISM – THE RIVAL TO THE CHRISTIANITY FOR OFFICIAL RELIGION OF THE ROMAN EMPIRE

Mithraism was an antique religion named after the sun deity of Mithra. Mithra was the Indo-Persian cult created in the 15th century BC in India that reached its peak during the 6th century BC in Persia, when the Roman soldiers and slaves brought it to Rome. In Dardania it had arrived from the East through Dacia and Danube, but this deity had not left many traces. In the territory inhabited by Dardanians the traces of this cult are found only in the region of Scupi and Kumanova, and in Janjeva, as in Macedonia and Greece, Mithra was not honored because of aversion to everything that comes from the East, but it seems that neither Illyrian local population did not voluntarily accepted this cult.

In Janjeva a stone stele of dimensions: 34 x 28 x 25 cm. was found. in the main area of which is preserved the scene of God Mithra with sacrifice of a bull and the accompanying scenes in the areas above and below.

Particularity of Mithraism was the 2nd century AD when it became serious rival to Christianity competing for the place of the official religion. Christianity had triumphed, while Mithraism had endured persecutions of Christians until the 5th century AD, when it was definitely extinct. Christianity had adopted many elements of the cult of Mithras which exist today in the Christian doctrine (baptism, a kind of communion, celibacy, holly water used for purification, bread marked with a cross, and wine which symbolizes blood, 12 students of Mithras whom Christianity converts into Christ's apostles, day by the holly day of Sunday, December 25 the birthday of Mithras that later was adopted for the birthday of Christ, the miracles of Mithras that were later attributed to Christ, the last supper, apotheosis (Ascension), return to earth as a savior and other).

In spite of Christian persecutions and destruction of the temples after 391, Mithraism survived until the 5th century.

Romans had received Mithras from Persia as deity of rank, in the context of war, while Christians regarded the mystical Mithraism rites as satanic. Christianity and Islam as well fought the veneration of this cult, even though Islamic Sufism has preserved many common elements with Mithraism, especially in terms of symbolism, mysticism and poetry concepts of Sufi literature that may have been inspired by elements of Mithraism philosophy and doctrine. Primarily these are related to the initiation (consecration) of the faithful which had certain number of levels (raven, groom, soldier, lion, Persian, messenger of the Sun and Father) as well as Sufi orders (Ashik, myhyb, dervish, sheikh, father Dede) and the Zichri ritual, which probably is inspired by the mystical rites of Mithraism.

Mithraizmi had left traces in many religions, and in particular serving as the forerunner to monotheistic faiths, which long time before under its doctrine had introduced the idea of resurrection and Savior's arrival.